



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 102/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Luri” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810300898 dhe seli në Hani i Elezit, kundër debitorit “Construct” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810775463 dhe seli në Lebanë, Komuna e Prishtinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.SH., avokat nga Prishtina, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 402/2022, i lejuar me datë 15.11.2022, nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 30.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “Construct” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810775463, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 402/2022, i lejuar me datë 15.11.2022, nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 20-SHV01-001-250 e datës 13.06.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-257 e datës 16.06.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-258 e datës 16.06.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-263 e datës 18.06.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-265 e datës 18.06.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-296 e datës 08.07.2020, Faturës nr. 20-SHV01-001-298 e datës 09.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-248 e datës 12.06.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-302 e datës 10.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-306 e datës 13.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-311 e datës 15.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-312 e datës 15.07.2020 Faturës nr. 20-SHV01-001-315 e datës 16.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-318 e datës 17.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-319 e datës 18.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-323 e datës 21.07.2020; Faturës nr. 20-

SHV01-001-324 e datës 21.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-327 e datës 22.07.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-329 e datës 23.07.2020 Faturës nr. 20-SHV01-001-371 e datës 12.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-372 e datës 13.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-375 e datës 14.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-376 e datës 15.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-378 e datës 17.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-381 e datës 18.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-379 e datës 18.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-389 e datës 21.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-393 e datës 22.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-398 e datës 26.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-401 e datës 27.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-402 e datës 28.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-406 e datës 31.08.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-409 e datës 01.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-413 e datës 03.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-418 e datës 05.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-419 e datës 07.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-422 e datës 08.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-425 e datës 09.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-427 e datës 10.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-430 e datës 11.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-433 e datës 14.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-434 e datës 15.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-439 e datës 16.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-440 e datës 16.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-442 e datës 18.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-448 e datës 21.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-455 e datës 24.09.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-496 e datës 20.10.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-497 e datës 21.10.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-500 e datës 22.10.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-498 e datës 22.10.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-501 e datës 23.10.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-543 e datës 26.11.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-545 e datës 27.11.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-548 e datës 01.12.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-554 e datës 03.12.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-560 e datës 07.12.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-561 e datës 08.12.2020; Faturës nr. 20-SHV01-001-562 e datës 10.12.2020; Faturës nr. 21-SHV01-001-5 e datës 05.02.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-74 e datës 27.04.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-76 e datës 29.04.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-77 e datës 30.04.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-79 e datës 01.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-83 e datës 07.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-89 e datës 13.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-93 e datës 15.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-100 e datës 17.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-102 e datës 18.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-105 e datës 19.05.2021; Faturës nr. 21-SHVOI-001-117 e datës 22.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-123 e datës 24.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-125 e datës 25.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-

133 e datës 27.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-138 e datës 28.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-145 e datës 31.05.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-149 e datës 01.06.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-152 e datës 02.06.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-155 e datës 03.06.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-158 e datës 04.06.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-169 e datës 07.06.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-179 e datës 11.06.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-182 e datës 12.06.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-288 e datës 23.07.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-298 e datës 27.07.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-305 e datës 28.07.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-304 e datës 28.07.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-306 e datës 29.07.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-307 e datës 30.07.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-312 e datës 31.07.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-313 e datës 03.08.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-315 e datës 04.08.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-330 e datës 12.08.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-378 e datës 09.09.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-382 e datës 11.09.2021; Faturës nr. 21-SHV01-001-385 e datës 14.09.2021; Faturës nr. 22-SHV01-001-347 e datës 28.09.2022; Faturës nr. 22-SHV01-001-382 e datës 28.10.2022; Faturës nr. 22-SHV01-001-380 e datës 27.10.2022, si dhe; Faturës nr. 22-SHV01-001-394 e datës 05.11.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 402/2022, të datës 15.11.2022, me të cilin është debitorit që kreditorit t'ia paguaj borxhit sipas faturave në vlerë prej EUR 223,709.42, me kamatë ligjore prej 8% në vit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Kundër këtij urdhri, debitori me datë 05.01.2023, përmes postës rekomande me numër R 2744335, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor në tërësi, me arsyetim se kreditori dhe debitori kanë pasur marrëveshje bashkëpunimi të shkëlqyera, mirëpo që kreditori pavarësisht kësaj nuk kishte kryer të gjitha obligimet ndaj debitorit. Me tej, ka theksuar se kreditori nuk ka ofruar shërbimet e faturuara dhe se i njëjti ka për qëllim të përfitimit të kundërligjshëm. Tutje, ka theksuar se nga kartela financiare e deponuar nga kreditori, vërehet se i njëjti i është referuar faturës së datës 01.01.2020 e cila përveç se ka qenë ditë pushimi, e njëjta fare nuk është përfshi në propozim për përmbarrim. Poashtu, ka theksuar se faturat nuk i janë dorëzuar debitorit asnjëherë, nga çka rezulton se as shërbimet objekt të faturës nuk janë dhënë, andaj edhe të njëjtat janë të papërshtatshme për përmbarrim. Në fund ka theksuar se debitori nuk ka pranuar asnjëherë pagesat që tani kreditori ka ndaj tij, ndërsa ka shtuar se debitori ka furnizuar kreditori me beton në vlerë prej EUR 1,200.000.00. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, urdhri përmbarrimor të anulohet, ndërsa të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguaj

shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimit, sipas rregullores mbi tarifat e avokatëve, në shumë prej EUR 312.00.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se urdhri është lejuar mbi bazën e dokumenteve të besueshme të cilat i plotësojnë kriteret nga neni 29 i LPP-së, ndërsa ka shtuar se prapësimi i debitorit përveç se është i pabazuar, i njejtë është paraqitur edhe pas kalimit të afatit ligjor. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që të njëjtin ta hurdhë poshtë si të pasafatëshëm.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm, për arsye si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se përmbaruesi privat Urdhrin Përmbarimor P.nr. 402/22, të datës 15.11.2022, ia ka dorëzuar debitorit me datë 23.12.2022, mirëpo që debitori ka refuzuar të nënshkruaj fletë dërgesën për dorëzim personal, fakt ky që vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal dhe shënimi zyrtar i përpiluar nga organi përmbarues i datës 23.12.2022, përmes së cilit është konstatuar se përkundër që debitori ka pranuar urdhrin përmbarimor dhe propozimin për përmbarim së bashku me faturat mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi, i njejtë ka refuzuar nënshkrimin e fletë dërgesës për dorëzim personal pa ndonjë arsye.

Andaj, meqenëse debitorit urdhri përmbarimor i është dorëzuar fizikisht me datë 23.12.2022, mirëpo ka refuzuar nënshkrimin e fletë dërgesës për dorëzim personal, rezulton se komunikimi me debitorin është kryer në mënyrë të rregullt, në kuptim të nenit 121.3 të Ligjit për procedurën kontesimore (LPK), sipas së cilës dispozitë përcaktohet se: *“Po që se marrësi refuzon ta firmosë dëftesën e komunikimit, komunikuesi do ta konstatojë një gjë të tillë në dëftesën e komunikimit dhe do ta shkruajë me shkronja datën e dorëzimit dhe kështu konsiderohet se është kryer dorëzimi i rregullt”*,

Në këtë drejtim, duke ju referuar dispozitës si më lartë, rezulton se urdhri përmbarimor debitorit i është dorëzuar me datë 23.12.2022, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 05.01.2023 përmes postës rekomande me numër R 22744335, e cili gjendet në shkresat e lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për procedurën përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore,

përcaktohet se “Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”

Në mbështetje të dispozitave si më lartë, si dhe nisur nga fakti se debitorit i është dorëzuar urdhri përmbarimor me datë 23.12.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 24.12.2022, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 30.12.2022. Prandaj, meqë debitori prapësimin e ka paraqitur përmes postës me datën 05.01.2022, fakt ky që vërtetohet nga vula e pranimit në postë me numër R 2744335, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova që prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pa afatëshëm.

Nga sa më sipër, gjykata konform nenit 73, paragrafi 3 të LPP-së, dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 102/23, datë 30.10.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.